




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

KRYETARI I KOMUNËS
Presednik Opštine – Municipal Mayor

**LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT,
Z. SMAJL LATIFI**

NGA DATA 12.05.2025 DERI MË 16.05.2025

NR.	EMRI I VENDIMIT	NR. I PROTOKOLLIT
1.	Vendim për punë shtesë.	NRP-02-5768-2025
2.	Vendim për Shpërblimin e Qytetarit për Kontribut në Mbrojtjen e Mjedisit.	NRP-02-5776-2025
3.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave.	NRP-02-5779-2025
4.	Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: "Rregullimi i catisë në palestrën sportive 'Mezahir Isma'".	NRP-02-5782-2025
5.	Vendim për qasje të pjesërishtme në dokumente publike.	NRP-02-5783-2025
6.	Vendim për refuzimin e mbështetjes nga Masat Emergjente të Riinegrimit për vazhdim të akomodimit.	NRP-02-5784-2025



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 5768 Nr. i faq/Br.str/No.pg 79

Data/Datum/Date 12 / 05 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 63, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa për punët shtesë dhe punë të paparapara e menaxherit të projektit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, e datës 29.4.2025, në projektin “**LOT 1 – ndërtimi i kanalit të tokave nga Shtavica deri në Fortesë**” me nr. të prokurimit: **623-21-2485-5-1-1/C298**, në shumën prej **190,641.15€ (njëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e një euro e pesëmbëdhjetë cent)**.
2. Ky vendim merret pasi është konstatuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe menaxheri i kontratës së projektit dhe nga verifikimi i gjendjes në terren, se projekti është në fazën përfundimtare dhe për t’u funksionalizuar është e nevojshme që të kryhen punë shtesë.
3. Obligohet Sektori i Prokurimit që t’i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zhvillimin e procedurave sipas ligjeve dhe akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe menaxheri i projektit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Zyrës së Prokurimit,
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,
- Menaxherit të projektit,
- Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESIDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No. 5776 Nr. i faq./Br.str./No.pg. 80

Data/Datum/Date 13/05/25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008”), nenit 12 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit (nr.03/L-025, nenit 63, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

PËR SHPËRBLIMIN E QYTETARIT PËR KONTRIBUT NË MBROJTJEN E MJEDISIT

1. Z. [REDACTED] me numër personal të letërnjoftimit [REDACTED] nga fshati Sapniq, komuna e Rahovecit, shpërblehet për denoncimin e bërë ndaj një rasti të hedhjes ilegale të mbeturinave në hapësirë publike, denoncim i cili ka rezultuar me identifikimin dhe me ndëshkimin e shkelësit nga Inspektorati komunal.
2. Z. [REDACTED] shpërblehet me shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, si vlerësim për kontributin në mbrojtjen e mjedisit dhe në nxitjen e përgjegjësisë qytetare.
3. Mjetet do të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit dhe do të derdhen në xhirollogari të [REDACTED] nr. [REDACTED] të Raiffeisen Bank.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Punë Inspektuese, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Ky vendim synon të inkurajojë qytetarët për bashkëpunim aktiv në luftimin e ndotjes së mjedisit dhe forcimin e ndërgjegjësimit publik për ruajtjen e ambientit të pastër në komunën e Rahovecit.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Z. [REDACTED]
- Drejtorisë për Punë Inspektuese,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI KRYETARIT TE KOMUNES / KABINET PRESEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 5779 Nr. i faq./Br.str./No.pg 80
Data/Datum/Date 14 / 05 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. Caktohet komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Ndërtimi i kompleksit sportiv në zonën turistike në Rahovec – Faza e tretë”, me Nr. prokurimi: 623-25-3274-5-2-1, dhe Nr. të brendshëm 623-25-032-5-2-1 të datës: 13.5.2025, në këtë përbërje:
 - 1.1. Egzon Thaqi, kryesues,
 - 1.2. Vjollca Berisha, anëtare,
 - 1.3. Faik Thaqi, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin “Ndërtimi i kompleksit sportiv në zonën turistike në Rahovec – Faza e tretë”, me Nr. prokurimi: 623-25-3274-5-2-1, dhe Nr. të brendshëm 623-25-032-5-2-1 të datës: 13.5.2025.
3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET	
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)	
Nr./Br./No	5782 Nr. i faq./Br.str./No.pg 81
Data/Datum/Date	15 / 05 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC	

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 28 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011"), nenit 19 paragrafi 19.16 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: "Rregullimi i çatisë në palestrën sportive 'Mizahir Isma'".

1. Muharem Morina, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Zyrtar për Kulturë, në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, **emërohet** person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: "Rregullimi i çatisë në palestrën sportive 'Mizahir Isma'".
2. Personi përgjegjës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ka për detyrë që të bëjë hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.
3. Përgjegjësitë e personit për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, janë:
 - 3.1. Në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtë të sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomikë, në përputhje me nenin 28 Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe akteve nënligjore (legjislacionit dytësor);
 - 3.2. Në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë;
 - 3.3. Të cilat nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, një procesi të hollësishëm, ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë, ose ndonjë prodhimi.

4. Personi përgjegjës obligohet që të hartojë specifikimet teknike / termat e referencës deri më datë 23.5.2025.
5. Personi përgjegjës obligohet që, së bashku me specifikimet teknike / termat e referencës, të dorëzojë edhe deklaratën në betim, të nënshkruar te Njësia e Prokurimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- ***Muharem Morina,***
- ***Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport,***
- ***Njësia e Prokurimit, dhe***
- ***Arkivi.***






Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për qasje në dokumente publike

1. **Miratohet pjesërishtë** e bazuar kërkesa me Nr. Prot. 02/5780, e datës 14.05.2025 për qasje në dokumente publike nga Enis Durguti dhe i ofrohet qasje e **pjesëshme** në dokumente publike në konkursin për ndarjen e bursave për studentë dhe nxënës të SHML-ve dhe të IAAP-së në Komunën e Rahovecit për vitin 2024/2025 dhe atë:
 - 1.1.Konkursin për ndarjen e bursave për studentë dhe nxënës të SHML-ve dhe të IAAP-së në Komunën e Rahovecit për vitin 2024/2025 me Nr. Prot. 531 i datës 25.03.2025;
 - 1.2.Vendimi për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e bursave për arsim për vitin akademik 2024/2025 me Nr. Prot. 02/5669 të datës 23.04.2025;
 - 1.3.Raportin e e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e bursave për arsim për vitin akademik 2024/2025 me Nr. Prot. 615 të datës 07.05.2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Në mbështetje të nenit 10 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 02/5780, e datës 14.05.2025 për qasje në dokumente publike nga Enis Durguti në konkursin për ndarjen e bursave për studentë dhe nxënës të SHML-ve dhe të IAAP-së në Komunën e Rahovecit për vitin 2024/2025 dhe atë:

- Konkursin për ndarjen e bursave për studentë dhe nxënës të SHML-ve dhe të IAAP-së në Komunën e Rahovecit për vitin 2024/2025 me Nr. Prot. 531 i datës 25.03.2025;
- Vendimi për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e bursave për arsim për vitin akademik 2024/2025 me Nr. Prot. 02/5669 të datës 23.04.2025;
- Raportin e e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e bursave për arsim për vitin akademik 2024/2025 me Nr. Prot. 615 të datës 07.05.2025.

Duke marrë parasysh se dokumentet tjera të kërkuara nga i lartpërmeduri (dosjet e aplikuesve) janë të mbrojtura me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komuna e Rahovecit nuk ka të drejtë ti ofrojë ato.

Andaj, pas shqyrtimit të kërkesës, të njëjtit i ofrohet qasje e pjesëshme në dokumente publike si në dispozitiv të këtij vendimi.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES/KABINET PRESEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 5784 Nr. i faq/Br.str/No.pg 81

Data/Datumi/Date 16 / 05 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 44, nën paragrafi 4.1 dhe 7 dhe paragrafi 5, neni 21, paragrafi 2 dhe 6, dhe neni 47, paragrafi 1, nenparagrafi 1.1, të Rregullores të QRK nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës së Rahovecit Nr.Prot. 271 të datës 14.7.2014 për themelimin e Komisionit Komunal për Riintegrim, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa e [redacted] me Nr. të Letërnjoftimi [redacted] e riatdhesuar nga Gjermania, për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegritimit për vazhdim të akomodimit.
2. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

Në seancën e mbajtur më datë 6.5.2025, Komisioni Komunal për Riintegrim ka shqyrtuar kërkesën e Komisionit të Ankesave për Riintegrim nga Ministria e Punëve të Brendshme, me nr. të vendimit 09-320/04-0014925/25 të datës 23.4.2025, lidhur me mbështetjen për vazhdimin e akomodimit me qira për znj. [redacted] një e riatdhesuar nga Komuna e Rahovecit, e cila aktualisht jeton në Prishtinë.

Pas shqyrtimit të detajuar, Komisioni ka marrë një vendim bazuar në faktet dhe rregulloret në fuqi si më poshtë:

Në pajtim me Rregulloren (QRK) nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, konkretisht nenin 21, pika 2, theksohet se akomodimi me qira mund të ofrohet deri në dymbëdhjetë (12) muaj.

Znj. [redacted] ka përfituar nga kjo masë që nga viti 2020 deri në prill 2025, për shkak se ishte klasifikuar si kategori e grupit të cenueshëm, gjegjësisht nënë vetëushqyese me fëmijë nën moshën 18 vjeç, në bazë të nenit 33 të rregullores.

Pas rivlerësimit të rastit të saj, është konstatuar se [redacted] nuk i përmbush më kriteret për të vazhduar të trajtohet si pjesë e grupit të cenueshëm, pasi fëmijët e saj tashmë kanë përmbushur moshën madhe +18 dhe poashtu e njejta nuk përfshihet më në asnjërin nga pikat përbërëse të Nenit 33, që kategorizon grup i cenueshëm.

Për këtë arsye, Komisioni Komunal për Riatdhesim në Rahovec, më datë 6.1.2025, ka refuzuar kërkesën për vazhdimin e përfitimit nga masa e qirasë. Edhe pse më pas, pas ankesës së znj. [redacted], MPB ka miratuar një zgjatje përfundimtare 6-mujore (më datë 15.1.2025), theksoj se ky përfitim ishte i përkohshëm dhe i bazuar në rrethanat e asaj kohe.

Po ashtu, edhe pas përfundimit të mbështetjes nga programi i riatdhesimit Komuna e Rahovecit ka qenë e gatshme të ofrojë ndihmë për integrim të mëtejshëm, mirëpo znj. [redacted] nuk ka pranuar të jetojë në territorin e Komunës sonë, por ka zgjedhur të jetojë në Komunën e Prishtinës. Si rrjedhojë, ne nuk kemi më kompetencë për të ofruar mbështetje për rastin e saj, pasi kjo e tejkalon juridiksionin e institucionit tonë.

Vendimi u dërgohet:

- [REDACTED]
- *Koordinatorit Rajonal MPB,*
- *Zyrës Komunale për Kthim dhe Komunitete, dhe*
- *Arkivit.*

